



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1168/3 prot

Datë 13/07/2023

V E N D I M
Nr. 602/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13/07/2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-64545-03-31-2023, me objekt “Shpenzime për DDD”, me fond limit 2,083,200 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 26.05.2023 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike- Bashkia Vlorë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Egian Med” SHPK
Adresa: Njësia Bashkiake Nr. 7, Rruga e Kavajës, Godina “Condor Centre”, Kati 4, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike- Bashkia Vlorë
Adresa: Lagjia “Kushtrimi”, Rruga “Dervish Hekali”, Vlorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, neni 24 e vijues, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të*

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.04.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-64545-03-31-2023, me objekt “Shpenzime për DDD”, me fond limit 2,083,200 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13.04.2023 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike- Bashkia Vlorë.

II.2. Në datën 11.04.2023, operatori ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK ka paraqitur ankesë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike ku është administruar ankesa me nr. 781 protokollit me datë 11.04.2023 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3019 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Në datë 11.05.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 369/2023, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-64545-03-31-2023, me objekt “Shpenzime për DDD”, me fond limit 2,083,200 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13.04.2023 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike- Bashkia Vlorë.*
2. *Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.4. Me shkresën nr. 160/8 prot., datë 19.05.2023, protokolluar me tonën nr. 781/5 prot., datë 11.05.2023, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike- Bashkia Vlorë, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 369/2023, datë 11.05.2023, si dhe ka publikuar shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit në përputhje me vendimin Nr. 369/2023, datë 11.05.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-64545-03-31-2023, me objekt “Shpenzime për DDD”, me fond limit 2,083,200 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13.04.2023 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike- Bashkia Vlorë.

II.5. Në datën 23.05.2023, operatori ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK ka paraqitur ankesë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike ku është administruar ankesa me nr. 1168 protokollin me datë 24.05.2023 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3126 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.7. Nëpërmjet shkresës e datës 01.06.2023 protokolluar me tonën me nr. 1168/2 prot., datë 06.06.2023 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.9. Në datë 12.07.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 597/2023, ku vendosi:

- 1. “Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-64545-03-31-2023, me objekt “Shpenzime për DDD”, me fond limit 2,083,200 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13.04.2023 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike- Bashkia Vlorë.*
- 2. Autoriteti kontraktor të zbatojë plotësisht pikat III.2.9. dhe III.4.10. të vendimit Nr. 369/2023, datë 11.05.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK se: “Procedura e ndjekur nga AK për hartimin e shtojcës për ndryshime në dokumentat e tenderit nuk është në përputhje me rregullat e prokurimit publik e konkretisht me Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”; si dhe në kundërshtim me VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për arsyet e mëposhtme:

Në radhë të parë nuk është e qartë nëse, AK-ja këtë shtojcë e ka hartuar në zbatim të vendimit të KPP-së Nr. 369/2023, datë 11.05.2023, apo është një shtojcë e hartuar nga Njësia e prokurimit me iniciativën e vet në mbështetje të nenit 75 të LPP-së sikurse e ka cituar edhe vet AK në

njoftimin që i paraprin shtojcës së ndryshimeve e pikërisht në pikën 9 të këtij njoftimi AK-ja argumenton se:

?9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit: Bazuar në nenin 75 të LPP, në dokumentat standarte do të kryhen modifikimet në specifikimet teknike të procedurës..”. Nëse, kjo shtojcë është hartuar me iniciativën e Njesisë së Prokurimit, atëherë përcaktimi i datës së re të tenderit dhe nxjerrja e procedurës së prokurimit nga pezullimi janë bërë në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik për arsyet si më poshtë:

për shkak të ankesës së paraqitur nga operatori ynë ekonomik, procedura e prokurimit ka qënë e pezulluar me vendim të kpp-së dhe për pasojë njësia e prokurimit përsa kohë që, nuk ka përfunduar shqyrtimi i plotë i ankesës së paraqitur nuk mund ta nxjerrë procedurën e prokurimit nga pezullimi i saj. referuar rregullave të prokurimit publik shqyrtimi i plotë i saj përfshin edhe:

- hartimin e shtojcës për modifikimin e dokumentet e tenderit në përputhje të plotë me konstatimet e vendimit nr. 369/2023, datë 11.05.2023 të komisionit të prokurimit publik;
- njoftimin e kësaj shtojce kpp-së, brenda 5 ditëve, për zbatimin e këtij vendimi;
- marrja e vendimin të kpp-së për heqjen e procedurës nga pezullimi në rast se kpp konstaton se shtojca është hartuar në përputhje me konstatimet e vendimit të kpp-së.

vetëm pas marrjes së vendimit të kpp-së, për heqjen nga pezullimi të procedurës së prokurimit, ak-ja ka të drejtë që nëse e gjykon të nevojshme në zbatim të nenit 75 të lpp te hedhë shtojca për ndryshimin e dokumentave të tenderit si dhe të shtyjë datën e fundit për pranimin e ofertave dhe rrjedhimisht edhe afatin e fundit për dorëzimin e mostrave të kërkuara në DT.

autoriteti kontraktor nuk ka hartuar një procesverbal të hartimit të shtojcës ku të argumentohen arsyet e hartimit të saj, pra nëse kjo shtojcë është në zbatim të vendimit të kpp-së apo është një shtojcë e cila është hartuar nga njësia e prokurimit me iniciativën e saj. në radhë të dytë: nëse kjo shtojcë është e hartuar nga ak-ja në zbatim të vendimit nr. 369/2023, datë 11.05.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, sërish e kundërshtojmë ATË SEPSE AJO NUK ËSHTË HARTUAR NË PËRPUTHJE ME KONSTATIMET DHE ARSYETIMIN E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK TË SHPREHURA NË KËTË VENDIM.....”

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.1.6. Në nenin 118 “Vendimet e Komisionit të Krokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.

3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

b) të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj;

c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji.”

III.1.7. Nga interpretimi në tërësi i dispozitës së sipërcituar del qartë qëllimi i normës juridike lidhur me të drejtën që gëzojnë operatorët ekonomikë për të ankimuar çdo lloj vendimi të marrë nga autoriteti kontraktor, i cili ka dëmtuar ose rrezikon të dëmtojë interesat e tyre në procedurat e prokurimit. Nga shqyrtimi i pretendimit të mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” sh.p.k., konstatohet se ky i fundit ngre përsëri pretendime në lidhje me modifikimin e kritereve, modifikimi i të cilit ka ardhur si rrjedhojë e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 369/2023 datë 11.05.2023.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në rastin konkret pretendimi i mësipërm i parashtruar në ankesë nga operatori ekonomik “Egian Med” sh.p.k. përbën “*gjë të gjykuar*”, për të cilat Komisioni është shprehur në vendimin Nr. 369/2023 datë 11.05.2023 si dhe vendimit Nr. 597/2023 datë 12.07.2023 ku Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka hequr pezullimin e procedurës object ankimi pasi nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë zbatuar të gjitha pikat e dhëna nga ana e komisionit. Në këtë kuptim, kjo çështje e pretenduar merr cilësinë e një çështjeje të shqyrtuar tashmë nga KPP, situatë kjo, analoge me çështjet që janë gjykuar njëherë nga gjykata, për të cilat zbatohet parimi i gjësë së gjykuar dhe për rrjedhim, *ipso lege*, pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim.

III.1.9. KPP thekson faktin se fuqia e “*res judicata*” (*gjësë së gjykuar*) mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit administrativ përfundimtar, por edhe rrethanat e çështjes të pranuar në shqyrtim, përfundimet dhe arsyet në të cilat është mbështetur ai vendim në pjesën arsyetuese dhe që kanë lidhje me atë që urdhëron organi administrativ në dispozitivin e vendimit të tij. Autoriteti kontraktor në publikimin e shtojcës për modifikimin e dokumenteve të tenderit të datës 19.05.2021, nuk ka zbatuar Vendimin Nr. 369/2023 datë 11.05.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me pretendimet e mësipërme dhe me vendimin Nr. 597/2023 datë 12.07.2023, Komisioni ka vendosur mos heqjen e pezullimit për të njëjtat pika të cilat operatori ekonomik “Egian Med” sh.p.k ngre pretendime. Në këtë kuptim, Komisioni nuk gjendet përballë asnjë rrethane të re për të cilën nuk ka qenë në dijeni në kohën e marrjes së vendimit përfundimtar.

Ankesa e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK qendron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

7. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-64545-03-31-2023, me objekt “Shpenzime për DDD”, me fond limit 2,083,200 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13.04.2023 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike-Bashkia Vlorë.
8. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
9. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
10. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK.
11. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
12. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

